



Përshëndetje të nderuar studentë!

Unë jam **Nil Çollaku**, lindur më **27.06.2006** në **Skenderaj**, dhe aktualisht jam **19 vjeç**. Jam student i **vitit të dytë** në drejtimin **“Doganë dhe Shpedicion”** në Kolegjin **Pjetër Budi**. Që në shkollën e mesme kam ndjekur shkollimin në drejtimin **“Logjistikë dhe Doganë”**, ku fillova të kuptoj bazat e shpedicionit, logjistikës, transportit, tregtisë së jashtme dhe doganave.

Deri tani kam kaluar përfunduar **10 provime** me notë **mesatare 9.6**, dhe këtë përkushtim dua ta sjell edhe në Parlamentin Studentor.

Që nga moshë **15-vjeçare kam qenë i angazhuar në biznesin familjar E-Commerc**, ku mësova menaxhim, organizim dhe komunikim me klientë nga **SHBA-ja, Kanada-ja dhe Mbretëria e Bashkuar**. Kjo eksperiencë më dha njohuri për eksportin, importin, shpërndarjen dhe logjistikën globale.

Kam kryer edhe **praktikë në Doganën e Kosovës, Terminali 3**, dhe kam marrë pjesë në **takime me Agjencinë e Akreditimit dhe Ambasadën e SHBA-së**, që më mësovan si të bashkëpunoj me institucione serioze dhe të mendoj strategjikisht, të bëj planifikime afatgjata.

Gjatë dy viteve në shkollën ekonomike **“Hoxhë Kadri Prishtina”**, isha **përgjegjës për fushatat e regjistrimit**, të mbështetura nga **GIZ-i Gjerman**, ku mësova se ide të qarta dhe organizimi bëjnë ndryshimin.

MISIONI IM është që **çdo ide e studentëve të dëgjohet dhe të kthehet në veprime konkrete**: të organizojmë projekte praktike, takime mujore, ekskursione, vizita institucionale, anketa për nevojat e tyre dhe aktivitete që përmirësojnë përditshmërinë në kolegji, duke e bërë Parlamentin Studentor të dobishëm për çdo student.

VIZIONI IM është të krijoj një Parlament Studentor aktiv, ku studentët ndihen të mbështetur, përfaqësuar dhe idetë e tyre të kthehen në projekte reale. Dua të jem **i hapur dhe gati t'i ndihmoj në çdo vështirësi dhe pyetje**, dhe gjithashtu të ofroj **mundësi për trajnime, aktivitete praktike dhe bashkëpunime profesionale**.

Lidershipi për mua nuk është thjesht të flasësh - është **të bashkoh njerëzit, të motivosh dhe të veprosh**. Si kryetar i Parlamentit Studentor, dua të sjell ndryshimin që secili student e meriton, me projekte reale, energji dhe bashkëpunim të sigurtë.

Andaj me respektin ma të lartë ju falënderoj nga zemra për votën e juaj për Kryetar të Parlamentit Studentor Faleminderit për mirëkuptimin e Juaj!

Me sinqeritet,
Nil Çollaku student

Curriculum Vitae – Kryetar i Kolegji Pjetër Budi (Doganë dhe Shpedicion)

Të dhënat personale

- Emri dhe Mbiemri: Nil Çollaku
- Data e lindjes: 27.05.2006
- Telefoni: 043/988-236
- Email: nilcollaku@gmail.com

Profil Profesional

Kryetar aktual i studentëve në **Kolegjin Pjetër Budi**, drejtimi **Doganë dhe Shpedicion**, me aftësi të spikatura udhëheqëse dhe përvojë në koordinimin e projekteve akademike dhe organizimin e aktiviteteve studentore.

- Udhëheqje e ekipeve dhe organizim i aktiviteteve akademike.
- Menaxhim i proceseve komplekse dhe komunikim efektiv me administratën.
- Zhvillim iniciativash që promovojnë progres, transparencë dhe përfaqësim korrekt të studentëve.

Edukimi

Kolegji Pjetër Budi – Drejtimi: Doganë dhe Shpedicion

2024 – aktualisht

- Lëndë kryesore: Bazat e Menaxhmentit, E Drejta Doganore, Ekonomia, Teknologjia Informativë, Anglishtja.
- Fokus në analitikë ekonomike, menaxhim zinxhiri furnizimi dhe procedura doganore.

Shkolla e Mesme – Hoxhë Kadri, Prishtinë – Drejtimi: Shpedicion dhe Logjistikë

2020 – 2024

- Fokus në ekonomi, logjistikë dhe administrim.

- Pjesëmarrje aktive në projektet klasore dhe organizimin e ngjarjeve shkollore.

Përvoja Profesionale

Agjent Kujdesi për Klientët – ArtMotion | Dhjetor 2024 – Shtator 2025

- Menaxhimi i komunikimit direkt me klientët dhe zgjidhja e kërkesave komplekse.
- Përmirësim i proceseve të shërbimit ndaj klientit dhe zhvillim aftësish profesionale në negociata dhe menaxhim situatash kritike.

Praktikant – Dogana e Kosovës | 2024

- Ndihmë në administrimin e dokumentacionit doganor dhe komunikim efektiv me departamentet përkatëse.

Ndihmës Shitës – ETC (Praktikë) | 2023

- Orientim dhe asistencë për klientët gjatë procesit të blerjes.

Aftësi Profesionale

- Udhëheqje dhe koordinim projektsh akademike dhe studentore.
- Aftësi të avancuara analitike në ekonomi, shpeditcion dhe doganë.
- Komunikim efektiv dhe negocim strategjik.
- Menaxhim i proceseve komplekse dhe punë me prioritete të larta.
- Njohuri të thella të teknologjisë informative dhe softuerëve profesionalë.

Aftësi Gjuhësore

- **Shqip:** Gjuha amtare
- **Anglisht:** C1 i certifikuar (88 pikë në testin ALCPT)

Punime Seminarike dhe Projekte Akademike

Fusha Kryesore – Doganë, Shpeditcion dhe Ekonomi

- **Ndikimi i Komunikimit në Imazhin e Bizneseve në Logjistikë** – Analizë e rolit të komunikimit në reputacionin e bizneseve logjistike.

- **Inflacioni dhe Ndikimi i Tij në Ekonominë e Kosovës** – Studim mbi efektet e inflacionit në treg dhe sektorë ekonomikë.
- **Roli i Doganave në Mbrojtjen e Tregut të Brendshëm** – Studim rasti për ndikimin e doganave në ekonominë vendore.
- **Roli i Mjeteve Autonome dhe Inteligjencës Artificiale në Avancimin e Zinxhirit të Furnizimit** – Analizë e ndikimit të teknologjive të avancuara në përmirësimin e efikasitetit dhe menaxhimin e zinxhirëve të furnizimit.
- **Optimizimi i Procesit të Deklarimit dhe Parandalimi i Kontrabandës përmes Inteligjencës Artificiale** – Përdorimi i AI për përmirësimin e procedurave doganore dhe parandalimin e kontrabandës.

Fusha të Tjera

- **Rëndësia e Planifikimit Strategjik në Suksesin e Organizatat** – Analizë e praktikave strategjike dhe ndikimi i tyre në performancën e organizatave.
- **Analiza e Trendëve të Tregut dhe Konkurrencës në Bizneset Lokale** – Studim mbi ndryshimet në kërkesën e tregut dhe përshtatjen e bizneseve lokale.
- **Roli i Marketingut Dixhital në Zhvillimin e Bizneseve të Vogla** – Analizë e ndikimit të fushatave online në rritjen e shitjeve dhe reputacionin e bizneseve.
- **Efikasiteti i Planifikimit Financiar në Organizatat e Mesme** – Punim mbi strategjitë financiare dhe menaxhimin e burimeve në kompani të mesme.

Arritje dhe Iniciativa si Kryetar

- Rritja e komunikimit mes studentëve dhe administratës përmes iniciativave të suksesshme.
- Promovimi i projekteve akademike dhe punimeve seminarike për publikun e gjerë.